



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:127725
Datë: 02.05.2024
Numri i dokumentit: 05649223

KPPP.nr. 1849/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbare të propozuesit / kreditorit të kundër përmbaremit "Printec L.L.C." SH.P.K., me seli në rr. "Lagja Mati 1", rruga B, ndërtesa 3/1, në Prishtinë, me NUI: 810522731, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Iliriana Osmani Serreqi, avokate nga Prishtina, ndaj debitorit të kundër përmbaremit "Data Systems L.L.C." SH.P.K., me NUI: 810805971, me seli në rr. "Janinës" 32/A, në Prishtinë, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës, jashtë seance, më datën 02.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, për të vendosur në çështjen juridike përmbaremit në mes të kreditorit të kundër përmbaremit "Printec L.L.C." SH.P.K., me dhe debitorit të kundër përmbaremit "Data Systems L.L.C." SH.P.K.
- II. Për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Propozuesi / kreditori i përbarimit “Printec L.L.C.” SH.P.K., me datë 30.09.2019, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka paraqitur propozim për kundër përbarim ndaj kundërshtarit të propozuesit / debitorit të k “Data Systems L.L.C.” SH.P.K.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin CP.nr. 2597/19, të datës 24.02.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për procedimin e kësaj çështje, ndërsa lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale të Kosovës.

Gjykata Komerciale, pas shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente Gjykata Themelore Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, për arsye si në vijim:

Kompetenca e Gjykatës Komerciale në çështjet përbarimore është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale, me të cilin në paragrafin 1, pika 1.2 përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.2. : të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përbarimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate.”*

Ndërsa, mjetet juridike në procedure përbarimore, konform ligjit të aplikueshëm, Ligji nr. 04/l-139 për Procedurën Përbarimore (tutje: LPP) janë te përcaktuara në nenin 67, sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Në procedurën përbarimore, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa”*.

Në rastin konkret, lënda e cila është transferuar në këtë gjykatë ka për objekt caktimin dhe zbatimin e përbarimit sipas propozimit për kundër përbarim të kreditorit “Printec L.L.C.” SH.P.K., ndaj debitorit të kundër përbarimit “Data Systems L.L.C.” SH.P.K., ndërsa nuk ka për objekt shqyrtimi mjetet juridike në procedurë përbarimore të përcaktuara në nenin 67 dhe 68 të LPP-së, ashtu që në kuptim të dispozitave nga neni 13, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, kjo gjykatë nuk ka kompetencë për vendosje në këtë çështje përbarimore.

Andaj, duke marrë parasysh faktin se objekt në këtë çështje përbarimore është caktimi dhe zbatimi i përbarimit nga gjykata si organ përbarues sipas propozimit për kundër përbarim të kreditorit, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë mjet juridik për të cilin

Gjykata Komerciale do të ishte e kompetencës për të vendosur, kjo gjykatë vlerëson se pikërisht Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm është gjykatë kompetente për vendosje në këtë çështje përmbarimore, kjo në mbështetje edhe të dispozitave nga neni 5 i LPP-së.

Nga sa më sipër, në kuptim të nenit 24 dhe 25.2 të Ligjit për procedurën kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit për procedurën përmbarimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVOËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1849/23, datë 02.05.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.